

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shqiptarët po hanë mish pule nga Tajlanda: KE alarm për kontaminim fekal
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1394333.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 17:01:17 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	26 shtator 2026, 16:49:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 26 shtator 2026, 16:48:00 UTC → 26 shtator 2026, 16:50:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1dba62d2e6c4345446a33c8f0a68aabc41e80fbbc5f7467a4ce1af228063d1ae
TEKSTI	2f48d2fcbf583e90522dde1bcc67dcbe861fcc3e2143bd7df3120325ead372f3
PAMJA	b44952655a362df25181d86121acfcc0766bb8af471fe6541508fae9e08abbd2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2db9715f28eea2d39023dc298cedce86077d5c98b69170494f1879cde3dfd269
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f11c1668384a0114026088dd439e5bbabdb3d48a586475de97c9d12c35b4ba6b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2db9715f28eea2d39023dc298cedce86077d5c98b69170494f1879cde3dfd269>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Shqiptarët po hanë mish pule nga Tajlanda: KE alarm për kontaminim fekal

Shkruar nga: M Gjini | Publikuar më: 26.09.2026, 18:49



Share



Share



Shqiptarët po konsumojnë mish pule të importuar nga Tajlanda, ndërsa raportet ndërkombëtare ngrenë pikëpyetje të mëdha mbi sigurinë ushqimore dhe kontrollet e këtij produkti.

Pas vendimit të 3 shtatorit ku BE-ja dhe Shqipëria ndaluan importin e disave kategorive të mishit nga Brazili, fabrikat e përpunimit të sallamit në vend duket se kanë gjetur një treg të ri furnizimi në Tajlandë. Që prej vitit 2025, Ministria e Bujqësisë i ka hapur rrugën këtij importi, me kushtin që produktet të vinin vetëm nga stabilimente të certifikuara për eksport në BE.

Mirëpo, të dhënat tregojnë se rreth 197 tonë mish pule tajlandez kanë hyrë në tregun shqiptar përmes Kosovës, si riekспорт.

Një auditim i kryer në qershor nga Komisioni European në Tajlandë ka zbuluar shkelje të rënda higjienike në thertoret dhe stabilimentet e prodhimit të mishit të shpendëve.

Nga raporti i Komisionit European:

"Komisioni konstatoi se, në pothuajse të gjitha stabilimentet e vizituara, karkasat me kontaminim fekal dërgoheshin për ripërpunim. Sipas raportit, mënyra e transferimit të këtyre karkasave, në disa raste, paraqiste rrezik serioz për përhapjen e kontaminimit fekal."


Sipas të njëjtit raport, karkasat e kontaminuara dërgoheshin në zona të tjera ku punonjësit thjesht prisnin pjesët e prekura, i lanin me ujë dhe vendosnin nëse mishi ishte i përshtatshëm për konsum.

Përveç higjienës, auditimi zbuloi edhe shkelje me gjurmueshmërinë e produktit: në një prej stabilimenteve u konstatua se për produktet e destinuara për eksport në BE ishte përdorur mish i grirë nga thertore të paautorizuara për tregun european.

Këto gjetje vënë në alarm sistemin e kontrollit dhe certifikimit, ndërsa kërkohet ndërhyrja e menjëhershme e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) dhe Ministrisë së Bujqësisë për të verifikuar në mënyrë rigoroze origjinën dhe sigurinë e mishit që përfundon në tavolinat e konsumatorëve shqiptarë.

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat



Alliance for
Media
Ethics

ARTIKULL JOETIK?

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne!

Marketing

Politika e privatësisë

Rreth Nesh

Kushtet e përdorimit

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.